



**RAPORT
MONITORIMI I SEKTORIT TË
MJEDISIT NË KOMUNËN E
LIPJANIT**

2024

MAJ, 2025



RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E LIPJANIT- 2024

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci Nr. 67, Prizren,
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7

www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org

029 222 771

Maj, 2025

PËRMBAJTJA :

HYRJE

GJETJET E RAPORTIT

- 1 Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor
Statistikat Kryesore - 2024:**
- 2 Korniza ligjore**
- 3 Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit**
- 4 Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
Raportet mjedisore në nivelin lokal**
- 5 Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave**
- 6 Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike**
- 7 Licencimi dhe lejet mjedisore**
- 8 PËRFUNDIME**
- 9 REKOMANDIMET**

HYRJE

Ky raport është një përpjekje e re e strukturuar e shoqërisë civile për të adresuar e trajtuar përgjegjësitë e organeve kompetente të Qeverisë Lokale, përkatësisht përgjegjësitë e Komunave karshi 7 aspekteve mjedisore që rregullohen me kornizën ligjore të vendit.

Organet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit janë të rregulluara në forma të ndryshme në Komunat e Kosovës. Disa nga komunat kanë drejtori të dedikuara për mbrojtjen e mjedisit, ndërsa disa kanë sektore në kuadër të drejtorive për planifikim apo zyrtarë përgjegjës për çështje mjedisore.

Metodologjia e ndjekur nga EC Ma Ndryshe për përpilimin e këtij raporti merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, si:

- Ligji nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit
- Ligji nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës
- Ligji nr.03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
- Ligji nr.2003_3 për pyjet e Kosovës
- Ligji nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës
- Ligji nr.04/L-060 për mbeturina
- Ligji nr.06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike
- Ligji nr.03/L-119 për produktet biocide dhe shtojcat
- Ligji nr.02/L-53 për gjuetinë
- Ligji nr.04/L-197 për kimikate
- Ligji nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor
- Ligji nr.04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.

Mbi këtë bazë përmbajtja e këtij raporti tenton që të mbulojë aspektet kryesore që legjislacioni në fuqi adreson, si:

- Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor
- Korniza ligjore
- Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit
- Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
- Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave
- Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike
- Licencimi dhe lejet mjedisore

Gjetjet e këtij raporti në kapituj të caktuar kanë identifikuar mangësitë aktuale në sektorin e mjedisit, që kërkojnë vëmendje më të shtuar nga autoritetet komunale, me qëllim të përmirësimit të procesit të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor. Gjithashtu ato janë validuar nga zyrtarët përkatës komunal, si pasqyrim i gjendjes reale në sektorin e mjedisit.

Në fund janë adresuar edhe disa rekomandime me qëllim të përmirësimeve dhe plotësimeve në proceset e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor, drejt arritjes së rezultateve më të qëndrueshme në sektorin e mjedisit dhe mbrojtjen e resurseve natyrore.

GJETJET E RAPORTIT

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Lipjanit organi përgjegjës për planifikim dhe menaxhim mjedisor është Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Sipas deklaratave të zyrtarëve të DPUMM-së në kuadër të kësaj drejtorie nuk ka sektor mjedisor dhe se në këtë drejtori kanë të angazhuar vetëm një zyrtar mjedisor.

Organi komunal	A është themeluar?	Emri zyrtar	Fuqia aktuale punëtore
Drejtoria	Po	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit	6
Sektor	Jo	/	/
Zyrtarët	Po	Zyrtarë mjedisor	1

Numri i angazhuar i shërbyesve civil në këtë drejtori thuhet se nuk është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore. Ndërsa, sa i përket pyetjes se a kanë shërbyesit civil profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave, zyrtarët e DPUMM kanë thënë se po dhe se përgaditja e tyre profesionale nga nga shkalla 1 (aspak) deri në 5 (shkëlqyeshëm) është vlerësuar me numrin 5.

DPUMM ka bërë të ditur se gjatë vitit 2024 për punonjësit e këtij sektori nuk janë organizuar trajnime rreth kornizës ligjore dhe rreth çështjeve mjedisore nga niveli qendror, ministria e mjedisit dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare.

Stafi i DPUMM gjatë vitit 2024 nuk ka shfrytëzuar ndonjë udhëzues profesional për planifikimin dhe menaxhimin e çështjeve mjedisore, por gjatë kryerjes së detyrave kryesisht është fokusuar në legjislacionin në fuqi dhe dokumentet strategjike për të cilat janë të obliguar t'i zbatojnë.

Statistikat Kryesore - 2024:

Kategoritë	Numri
Numri i zyrtarëve të angazhuar në DShPAI	1
Trajnimet rreth kornizës ligjore	0
Trajnimet sipas fushës mjedisore	4
Udhëzues Profesional për Planifikimin dhe Menaxhimin Mjedisor	1

Korniza ligjore

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Lipjan, përkatësisht DPUMM ka raportuar se mbështetet në këto dokumente ligjore:

1. Ligjin për Planifikim Hapësinor
2. Ligjin Nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit
3. Ligjin Nr. 02/L-30 për Menaxhim të Mbeturinave
4. Ligjin 04/L-175 për Inspektim
5. Ligjin Nr. 03/L-024 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
6. Ligjin Nr. 03/L-015 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor
7. Ligji Nr.02/L-102 Ligji për Mbrojtje nga Zhurma
8. Ligji Nr. 03/L-160 Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja,
9. Ligjin Nr.04/ L-147 për Ujëra, etj.,

Ndërsa në kuadër të Udhëzimeve Administrative shfrytëzohen:

1. U.A Nr.01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale,
2. U.A Nr.14/2015 për Ndëshkim me Gjoba Mandatore,
3. U.A Nr.01/2020 për Menaxhimin e Mbeturinave që përmbajnë azbest,
4. U.A Nr. 06/2018 për Ndëshkimet me Gjoba Mandatore,
5. U.A Nr.03 /2018 për Procedurat për Leje Ujore,
6. U.A Nr. 07/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore.

Zyrtarët e DPUMM të Komunës së Lipjanit kanë vlerësuar se korniza ligjore është pjesërisht e konsoliduar dhe kanë vlerësuar me 3 njohuritë e stafit rreth kornizës ligjore (1/aspak - 5/shkëlqyeshëm). Si mangësi në kornizën ligjore zyrtarët kanë përmendur paqartësitë në definimin e saktë të rasteve kur nevojitet VNM dhe kur LMK.

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Gjatë vitit 2024 DPUMM ka hartuar dokumente të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Një nga dokumentet kryesore të hartuara është Plani Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave, i cili përcakton hapat për trajtimin efikas dhe të qëndrueshëm të mbeturinave në nivel lokal.

Strategjitë mjedisore lokale janë harmonizuar me strategjitë qendrore, duke siguruar përputhje të plotë me objektivat dhe politikat kombëtare për mbrojtjen e mjedisit.

DPUMM ka zhvilluar projekte të shumta për rregullimin, promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit, të cilat përfshijnë:

- Mbjelljen e drunjve në zona urbane dhe rurale,
- Aksione pastrimi në lokacione të ndryshme si përgjatë lumenjve, rrugëve dhe nëpër deponi ilegale.

Gjithashtu janë ndërmarrë masa konkrete për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përmes:

- Zbatimit të lejeve mjedisore për aktivitete që ndikojnë në mjedis,
- Monitorimit dhe vlerësimit të aspekteve mjedisore të projekteve potencialisht të dëmshme.

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore për mbrojtjen e mjedisit realizohet në mënyrë të rregullt nga departamenti përkatës. Për secilin inspektim hartohen raporte për zbatimin e kornizës ligjore, të cilat dokumentojnë gjetjet në terren dhe shërbejnë si bazë për marrjen e masave të mëtejshme. Po ashtu, hartohen edhe raporte të monitorimit të zbatimit të strategjive mjedisore, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e progresit dhe identifikimin e sfidave në zbatim.

Gjendja e deponive të mbeturinave monitorohet në mënyrë sistematike, me qëllim të kontrollit të ndotjes dhe menaxhimit të mbetjeve në përputhje me standardet mjedisore. Në disa raste janë zhvilluar vlerësime të ndikimit të deponive ekzistuese në mjedis, duke evidentuar efektet e mundshme në tokë, ujë dhe ajër, si dhe ndikimin në shëndetin publik.

Gjatë inspektimeve janë identifikuar çrregullime mjedisore të shkaktuara nga aktivitete të personave fizik dhe juridik. Disa nga rastet përfshijnë:

- Deponi ilegale të mbeturinave në zona të ndryshme,
- Mbushja e parcelave me mbeturina inerte (si materiale ndërtimore), pa leje të nevojshme.

Lidhur me tejkalimin e eksploatimit të resurseve natyrore mbi kushtet e lejuara, nuk janë identifikuar raste, pasi kjo është kompetencë e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI).

Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Komuna e Lipjanit aktualisht nuk posedon sistem të monitorimit të cilësisë së ajrit, dhe për rrjedhojë nuk ka stacione funksionale për këtë qëllim, as mbikëqyrje sistematike të cilësisë së ajrit në intervale të caktuara kohore.

Gjithashtu, nuk ka sistem të monitorimit të dheut, dhe as ndonjë formë të mbikëqyrjes sistematike të cilësisë së tij.

Për sa i përket cilësisë së ujërave, nuk ekziston sistem i monitorimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në komunë. Si pasojë, nuk ka stacione funksionale, dhe as mbikëqyrje të rregullt të cilësisë së ujit.

DPUMM nuk ka ndërtuar ende një sistem të menaxhimit të të dhënave mjedisore.

Gjithashtu, nuk posedon kapacitetet e nevojshme teknike për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e këtyre të dhënave. Mungesa e pajisjeve, financave dhe projekteve të dedikuara përbën një pengesë kryesore në këtë drejtim.

Përveç mangësive teknike, ekzistojnë edhe mangësi në kapacitetet njerëzore, veçanërisht në aspektin numerik dhe të profileve profesionale të domosdoshme. Departamenti përballet me mungesë të stafit të specializuar në fushat e monitorimit mjedisor, të dhënave statistikore dhe teknologjisë së informacionit për mjedisin.

Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore si dhe në hartimin e strategjive mjedisore është vlerësuar në nivel mesatar (nota 3). Kjo tregon për një bashkëpunim që ekziston, por që ende ka hapësirë për përmirësim, sidomos në aspektin e përfshirjes më të strukturuar të nivelit lokal në proceset vendimmarrëse.

Në lidhje me bashkëpunimin me organizatat joqeveritare, ai është vlerësuar më pozitivisht, me notën 4. Janë theksuar si shembuj konkretë të këtij bashkëpunimi punëtoritë e Ekipit Teknik për Bashkëpunimin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave, të organizuara nga GIZ dhe MMPHI me komunat, si dhe takimet e organizuara nga JICA dhe AMMK për hartimin e Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Republikën e Kosovës 2024-2035 dhe Planit të Veprimit 2024-2026.

Komuna ka ndërmarrë procese me pjesëmarrje publike gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor, duke përfshirë konsultime dhe mbledhje me palët e interesit lokal. Megjithatë, pjesëmarrja publike është vlerësuar mesatarisht e kënaqshme (nota 3), duke sugjeruar se megjithëse qytetarët janë ftuar të marrin pjesë, niveli i përfshirjes dhe ndikimit të tyre në vendimmarrje ende mund të përmirësohet.

Licencimi dhe lejet mjedisore

Komuna nuk lëshon licenca për shfrytëzim të resurseve natyrore. Kompetenca për këtë i takon nivelit qendror. Departamenti komunal lëshon vetëm Leje Mjedisore Komunale, të cilat janë të domosdoshme për projektet që mund të shkaktojnë ndikim në mjedis.

Gjatë vitit 2024 janë lëshuar gjithsej 46 Leje Mjedisore Komunale, të kategorizuara sipas llojit të aktivitetit, si më poshtë:

Lloji i aktivitetit	Numri i lejeve
Objekte afariste	11
Objekte afariste - banesore	15
Depo të ndryshme	15
Ferma të shpezëve	2
Stacione të telefonisë mobile	2
Automekanik	1
Totali	46

Në shqyrtimin e lëndëve për leje mjedisore trajtohen aspektet që lidhen me ndikimet në: tokë, ajër, ujë, florë dhe faunë, gjenerimin e mbeturinave, zhurmën, procesin teknologjik të punës, si dhe masat për rehabilitim të sipërfaqeve të gjelbra. Po ashtu, vlerësohen masat në rast aksidenti, masat për efikasitetin e energjisë, përfshirë caktimin e lokacionit të kontejnerëve në situacion, mbjelljen dhe vendosjen e drunjëve. Këto masa synojnë kontrollimin e ndikimeve negative mjedisore dhe reduktimin e tyre në nivele të pranueshme.

PËRFUNDIME

Në Komunën e Lipjanit organi përgjegjës për planifikim dhe menaxhim mjedisor është Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Sipas deklaratave të zyrtarëve të DPUMM-së në kuadër të kësaj drejtorie nuk ka sektor mjedisor dhe se në këtë drejtori kanë të angazhuar vetëm një zyrtar mjedisor.

Korniza ligjore mjedisore është pjesërisht e konsoliduar dhe njohuritë e stafit komunal rreth kornizës mjedisore janë të nivelit mesatar.

Shkalla e hartimit dhe zbatimit të politikave lokale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor mbetet problematik, për faktin se nuk ka organizim të mirëfilltë në këtë aspekt; përkatësisht, rrjedha aktuale e hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit aktualisht e bën të vështirë matjen e efikasitetit të këtyre veprimeve në përmirësimin e gjendjes mjedisore.

Inspektimi i zbatimit të ligjit për mbrojtjen e mjedisit realizohet rregullisht dhe dokumentohet me raporte. Gjendja e deponive monitorohet për të kontrolluar ndotjen. Janë bërë vlerësime për ndikimin e deponive në mjedis dhe shëndetin publik. Gjatë inspektimeve, janë identifikuar çrregullime mjedisore si deponi ilegale dhe mbushje parcelash me mbeturina inerte. Nuk ka raste të tejkalimit të eksploatimit të resurseve natyrore.

Komuna e Lipjanit nuk ka sistem të monitorimit të cilësisë së ajrit, dhe as stacione funksionale për këtë qëllim, duke shkaktuar mungesë të mbikëqyrjes sistematike. Po ashtu, nuk ekzistojnë sisteme monitorimi për dheun dhe ujërat, dhe mungojnë stacionet funksionale për monitorimin e këtyre elementëve. DPUMM nuk ka ndërtuar ende një sistem menaxhimi të të dhënave mjedisore për shkak të mungesës së pajisjeve, financave dhe projekteve të dedikuara. Gjithashtu, ka mangësi në kapacitetet njerëzore, sidomos në profilet profesionale të nevojshme për monitorimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

Bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe strategjive mjedisore është vlerësuar mesatarisht, duke treguar që ka mundësi për përmirësim në përfshirjen e nivelit lokal. Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare ka marrë një vlerësim më të lartë, duke theksuar shembuj konkretë të aktiviteteve të përbashkëta.

Komuna ka realizuar procese me pjesëmarrje publike, por pjesëmarrja e qytetarëve është vlerësuar mesatarisht, duke sugjeruar se ka hapësirë për përmirësim në përfshirjen dhe ndikimin e tyre në vendimmarrje.

Sa i përket lejeve mjedisore në kuadër të DPUMM zyrtarët kanë raportuar se kanë lëshuar gjithsej 46 Leje Mjedisore Komunale.

REKOMANDIMET

- Të shqyrtohen mundësitë për shtimin e një sektori për mbrojtjen e mjedisit në DPUMM;
- Të shqyrtohen mundësitë për shtimin e punonjësve profesionistë në DPUMM;
- Të organizohen më shumë trajnime për punonjësit e DPUMM rreth kornizës ligjore dhe rreth çështjeve mjedisore;
- Të përmirësohet dhe dinamizohet hartimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit;
- Planet e nivelit lokal për menaxhimin mjedisor të përditësohen, bashkë me fuqizimin e raportimit të zbatimit të tyre;
- Të rriten kapacitetet si dhe të shtohet mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor;
- Të fillojë sa më shpejtë procesi i krijimit, grumbullimit, menaxhimit të të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të të dhënave mjedisore;
- Të avancohet bashkëpunimi nivel qendror - lokal në hartimin e akteve ligjore dhe strategjive mjedisore; dhe
- Të kultivohet bashkëpunimi më i afërt me OJQ-të për të nxitur rritjen e pjesëmarrjes së publikut në çështjet mjedisore;

Për EC:

EC Ma Ndryshe është organizatë me bazë në komunitet, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm me qasje gjithëpërfshirëse.

Aktivizmi i EC-it synon një Kosovë ku qeverisja demokratike është pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar që institucionet, komunitetet dhe palët e interesit të punojnë së bashku drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Ky vizion promovon vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, politika më të fuqishme dhe përfshirje më të madhe të publikut, duke siguruar që qëndrueshmëria të jetë pjesë përbërëse e qeverisjes si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar.

Përmes koordinimit më të mirë institucional, hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe angazhimit qytetar, angazhimi i EC-së synon të kapërcejë hendekun mes komuniteteve dhe institucioneve, duke siguruar që qeverisja e mirë të sjellë ndryshime të prekshme dhe afatgjata.

Deklarata e vizionit

“Fuqizimi i një Kosove elastike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet në mënyrë aktive formojnë institucione të qëndrueshme, të digjitalizuara dhe të ndërgjegjshme”.

Deklarata e misionit

“EC Ma Ndryshe përkrah qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik, kulturor dhe të gjelbër përmes edukimit digjital, kujdestarisë mjedisore, mobilizimit të komuniteteve, avokimit për vendimmarrje publike me pjesëmarrje dhe kultivimit të partneriteteve strategjike”.